URDHËR
Nr. 19, datë 9.2.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 16, DATË 28.1.2025,
"PËR DELEGIM KOMPETENCE"

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në nenet 11 dhe 14, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 16, datë 28.1.2025, "Për delegim kompetence", pika 1, shkronja "a", ndryshon si më poshtë:

"a) Lëshimin e autorizimeve për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Financave në të gjitha proceset gjyqësore dhe procedurat gjyqësore, në të cilat ministria paraqitet si palë në gjykim ose si subjekt i interesuar, si dhe për hartimin, nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesëpadive, dhe të çdo akti tjetër procedural, në përputhje me formatin e autorizimit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe që përbën pjesë përbërëse të tij.".

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E ANKESAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Nr. _____Prot. Tiranë, më ____/____/2026

AUTORIZIM PËR PËRFAQËSIM

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe të Urdhrit të Ministrit Financave nr.___, datë _____ "Për delegim kompetence", në çështjen civile/administrative me palë ndërgjyqëse:

Paditës/Kërkues:

I paditur:

Person i tretë:

Objekti:

VENDOSA:

Autorizimin e Z/Znj. _____, me detyrë _____ dhe Z/Znj _____, me detyrë _____, që së bashku ose veç e veç, të përfaqësojnë Ministrinë e Financave në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile/administrative me palë dhe objektin e sipërcituar. Përfaqësuesi ka të drejtën të hartojë, nënshkruajë dhe të dorëzojë kërkesëpadi, kundërpadi, kundërshtim veprimesh përmbarimore, kërkesa të tjera procedurale, prapësime, deklarata mbrojtje, ankim, ankim të veçantë dhe çdo akt tjetër procedural që ka lidhje me gjykimin e kësaj çështje, në përputhje me ligjin dhe në interesin e ligjshëm të Ministrisë së Financave, deri në përfundim të procesit gjyqësor. Në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, përfaqësuesit e autorizuar kanë të drejtë të hartojnë draft-rekursin dhe draft-kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për paraqitje në Gjykatën e Lartë, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Gentian Këri